

Dokë : 25.04.2022

AKT THEMELIMI
"AZIMUTE MILIONARIO" SHPK



Armando ALA, shtetas italian, i biri i Giovanni-it, lindur më 06,02,1962, në Cantolra, Torino, Itali dhe banues në R .Custòdio Domingos Neto , 6 1. °C Olhào 8700-292 Portugali, mbajtës i Pashaportës Nr. YB5690784.

Claudio ALA, shtetas italian, i biri i Armando-s, lindur më 28,05,1998, lindur në Moncalieri, Itali dhe banues në R .Custòdio Domingos Neto , 6 1. °C Olhào 8700-292 Portugali , mbajtës i Pashaportës me Nr. YB6512436.

Të angazhuar për të themeluar një shoqëri të re tregtare në Shqipëri, duke kuptuar plotësisht legjislacionin Shqiptar në lidhje me shoqëritë tregtare si dhe duke patur në dispozicion të gjitha mjetet e nevojshme financiare si dhe idetë për të themeluar një biznes, nëpërmjet këtij akti, të hartuar dhe nënshkruar sot më datë 25.04.2022, shprehin vullnetin e tyre të lirë dhe angazhimin për të themeluar një "Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar", si vijon:

1. Forma ligjore dhe emri i shoqërisë.

Emri i shoqërisë do të jetë **"AZIMUTE MILIONARIO" SHPK**, e quajtur më poshtë me emrin "shoqëria", e cila themelohet si një shoqëri tregtare në formën e "Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar" ose "SHPK".


2. Ortakët e shoqërisë.

Ortakët janë:

- **Armando ALA**, shtetas italian, i biri i Giovanni-it, lindur më 06,02,1962, në Cantolra, Torino, Itali dhe banues në R .Custòdio Domingos Neto , 6 1. °C Olhào 8700-292 Portugali, mbajtës i Pashaportës Nr. YB5690784.
- **Claudio ALA**, shtetas italian, i biri i Armando-s, lindur më 28,05,1998, lindur në Moncalieri, Itali dhe banues në R .Custòdio Domingos Neto , 6 1. °C Olhào 8700-292 Portugali , mbajtës i Pashaportës me Nr. YB6512436.

3. Objekti i veprimtarisë.

- Objekti i veprimtarisë do të jetë:
 - Blerja dhe shitja e produkteve dhe shërbimeve online, shërbimet e marketingut në WEB;
 - Realizimi i projekteve të komunikimit të marketingut dhe reklamimit dhe zbatimi i tyre në emër të organeve publike, kompanive private dhe për veten e tyre, për prezantimin dhe nxitjen e shitjeve, në tregjet evropiane dhe jashtë-evropiane, të produkteve dhe shërbimeve, blerjen dhe shitjen e kriptomonedhave drejtpërdrejt, për publikun e gjerë nëpërmjet një platforme të shitjeve direkte online, në pronësi ose nga palë të treta, në një vend fizik (kioskë) dhe nëpërmjet makinave automatike shitëse (ATM).

- 
- Ofrimi i shërbimeve të transferimit, pagesat në asete dixhitale, ruajtje e aseteve dixhitale, për llogarë të palëve të treta. Zhvillimi, shitja, rishitja, marrja me qira e softuerit të platformës dixhitale për tregti, blerje, shitje, huadhënie, kujdestari, depozitimi dhe investimi i aseteve dixhitale.

- Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë mund të ndryshohet ose shtohet me vendimin e Asamblesë së ortakëve.

4. Selia e shoqërisë.

- Selia e Shoqërisë do të jetë në adresën: **Njesia Bashkiake nr. 7, Rruga “Muhamet Gjollësja”, 200 m mbrapa Mondial, Pallati 24, Hyrja 1, kati 2, Apartamenti 4.**
- Shoqëria mund të hapë degë dhe/ose zyra përfaqësie, brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, si dhe mund të marrë pjesë në shoqëri të tjera shqiptare dhe/ose të huaja, që ekzistojnë ose do të krijohen në të ardhmen. Këto mund të krijohen ose mbyllen me një vendim të thjeshtë të administratorit.

5. Kohëzgjatja e shoqërisë.

- Afati i veprimtarisë së Shoqërisë është **i pacaktuar**. Ky afat fillon nga data e regjistrimit të saj në Regjistrin Tregtar të Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

6. Kapitali themeltar.

- Kapitali themeltar i shoqërisë është **100 000 All (njëqind mijë)**
- Ortaku, **Armando ALA** zotëron **50 %** të kapitalit themeltar, ose **1 (një) kuotë**, me vlerë nominale **50 000 ALL (Lekë)**.
- Ortaku, **Claudio ALA** zotëron **50 %** të kapitalit themeltar, ose **1 (një) kuotë**, me vlerë nominale **50 000 ALL (Lekë)**

7. Organet vendimmarrëse të shoqërisë.

- Organet vendimmarrëse të shoqërisë janë:
 - Asambleja e Ortakëve.
 - Administratori.

8. Administratori

- Administratori emërohet për një mandat 5 (pesë) vjeçar. Ai zëvendësohet ose shkarkohet nga kjo detyrë me vendim të Asamblesë së Ortakëve. Mandati është i rinovueshëm.
- Administratori i parë shoqërisë do të jetë:

-
- **Claudio ALA**, shtetas italian, i biri i Armando-s, lindur më 28.05.1998, lindur në në Montalieri, Itali dhe banues në R. Custódio Domingos Neto , 6 1. °C Olhão 8700-292 Portugali , mbajtës i Pashportës me Nr. YB6512436.

9. Likuidimi i shoqërisë

Në rast falimentimi, shoqëria do të likuidohet në përputhje me dispozitat në fuqi në legjislacionin shqiptar.


Z. Armando ALA
ARMANDO ALA

ORTAKËT:


Z. Claudio ALA
CLAUDIO ALA

Përkthyes:
Vjollca Meta



Date : 25.04.2022

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË
NOTER ARDJANA A. MEDIU**



**DATE 25/04/2022
NR REP 2312**

VËRTETIM NËNSHKRIMI

Sot, më datë 25.04.2022, para meje Notere ARDJANA A. MEDIU, anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore Tiranë, me zyrë në adresën Tirane, Blv."Dëshmorët e Kombit", Kullat Binjake, Kulla Nr.2, Kati i 7, u paraqitën personalisht:

DEKLARUESIT:

Armando ALA, shtetas italian, i biri i Giovanni-it, lindur më 06,02,1962, në Cantoira, Torino, Itali dhe banues në R .Custòdio Domingos Neto , 6 l. °C Olhão 8700-292 Portugali, mbajtës i Pashaportës Nr. YB5690784.

Claudio ALA, shtetas italian, i biri i Armando-s, lindur më 28,05,1998, lindur në Moncalieri, Itali dhe banues në R .Custòdio Domingos Neto , 6 l. °C Olhão 8700-292 Portugali , mbajtës i Pashaportës me Nr. YB6512436.

Të cilët në vullnet të lirë dhe të plotë dhe në prezencë të përkthyeses së gjuhës Italiane Zj.Vjollca Meta, u paraqitën dhe nënshkruan përpara meje Noteres, Akt Themelim i Shoqërisë "AZIMUTE MILIONARIO" SHPK, datë 25.04.2022, bashkëlidhur.

Unë Noterja, pasi verifikova identitetin e personave të sipërcituar, nëpërmjet mjeteve të identifikimit në përputhje të plotë me nenin 62, pika 1, gërma "ë", si dhe nenit 128 të ligjit nr. 110/2018 "Për Noterinë", dhe Udhëzimit të Ministrisë së Drejtësisë nr. 6291, datë 17.08.2005; vërtetoj nënshkrimin e tyre.

Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë noterja deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjektit të këtij veprimi në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

**NOTERE
ARDJANA A. MEDIU**

